

Edicioni i 13-të i Çmimit Ndërkombëtar Japonez për MANGA-t

Udhëzime për Aplikimin

1. Qëllimi

Përhapja e kulturës së MANGA-ve jashtë vendit dhe promovimi ndërkombëtar i shkëmbimeve kulturore përmes MANGA-ve.

2. Çmimi

(1) Çmimi i Artë për Edicionin e 13-të të Çmimit Ndërkombëtar Japonez për MANGA-t do t'i jepet punimit më të mirë MANGA dhe Çmimi i Argjendtë do t'u jepet tre veprave të tjera të shkëlqyera.

(2) Fituesi i Çmimit të Artë dhe fituesit e Çmimit të Argjendtë do të marrin ftesa për një udhëtim në Japoni për një periudhë 10 ditore si pjesë e çmimit me rastin e ceremonisë së dhënies së çmimeve (fituesit e tjerë të punimeve të mira nuk e kanë këtë të drejtë).

3. Kushtet e hyrjes

(1) Punimet MANGA që do të pranohen duhet të kenë më shumë se 16 faqe. Si veprat e botuara qoftë edhe ato të pabotuara janë të kualifikueshme për të aplikuar, duke përjashtuar ato vepra që në të kaluarën kanë fituara Çmimin Ndërkombëtar Japonez për MANGA-t.

(2) Punimet MANGA që do të pranohen duhet të jenë prodhuar përgjatë tre viteve të fundit, (2016-2019) nga data e aplikimit.

(3) Punimet MANGA që do të pranohen duhet të dërgohen në formë të printuar. (Dërgimi i të dhënave të tjera mund të kërkohet më pas).

(4) Kompani të huaja botuese, mund të aplikojnë për Çmimin Ndërkombëtar Japonez për MANGA-t, pas marrjes së aprovimit nga artistët.

(5) Artisti ilustrues ose autori i historisë së punimit të dorëzuar duhet të jetë nënshkruar i huaj. Gjithashtu përfaqësuesi që do të marrë pjesë në programin e ftesave që u jepet fituesve të Çmimit të Artë dhe Çmimit të Argjendtë duhet të jetë nënshkruar i huaj.

(6) Çdo aplikant mund të dorëzojë vetëm një punim.

Me një titull (ose seri) mund të pranohet vetëm një punim.

Në rastin kur punimi është një koleksion me histori të shkurtra, vetëm një histori do të pranohet për shqyrtim.

Aplikimet e dyfishta nuk do të jenë të vlefshme.

(7) Për qëllime publicitare, Komiteti Ekzekutiv i Çmimit MANGA mund të publikojë (pjesërisht) online punimet MANGA të fituesit në faqen e tij, pas marrjes së aprovimit nga artisti.

4. Si të aplikohet

(1) Periudha e Aplikimit

8 Prill 2019 – 14 Qershor 2019 (aplikimet duhet të dorëzohen deri në këtë datë)

(2) Aplikimi duhet ti dërgohet ose i) ose ii) më poshtë.

i) Ambasadave ose Konsullatave të Përgjithshme Japoneze (Kontrolloni online për secilën adresë)

ii) Kutisë Postare

të pyeten Ambasadat ose Konsullatat e Përgjithshme Japoneze.

(3) Duhet të dërgohoni **dy kopje** të punimit tuaj.

(Kopje shtesë mund të kërkohen për punime të cilat janë duke u marrë në konsideratë për një çmim).

(4) Një formular aplikimi i plotësuar në gjuhën Angleze ose Japoneze duhet t'i bashkëngjitet punimit.

Numri i secilës prej faqeve duhet të jetë i dallueshëm në çdo faqe të punimit.

Nëse punimi nuk është në formën e një libri, duhet të specifikohet qartësisht nëse ka një pjesë specifike që shtrihet në dy faqe.

5. Kthimi i punimeve

Punimet e dërguara **nuk** do t'u rikthehen aplikantëve. Rrjedhimisht, nëse punimi ende nuk është publikuar, ju këshillojmë të dorëzoni një kopje të tij dhe të mbani origjinalin. Kopjet e dërguara mund të dhurohen ose ekspozohen.

6. Përzgjedhja

Komiteti Përzgjedhës i Edicionit të 13-të të Çmimit Ndërkombëtar Japonez për MANGA-t do të jetë institucioni përgjegjës për procedurat e përzgjedhjes.

7. Ceremonia e ndarjes së çmimeve

Ceremonia e ndarjes së çmimeve është planifikuar të mbahet në Tokio, në Shkurt të vitit 2020.

(FUND)